



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.63, datë 13.09. 2018

MBI

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT “PC
STORE” SH.P.K, KUNDËR MASËS ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME
GJOBË”.**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj Sara Recic, në mbledhjen e datës 13.09.2018, në mbështetje të Ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“SHQYRTIMI I ANKIMIT ADMINISTRATIV TË SIPËRMARRËSIT “PC STORE”
SH.P.K, KUNDËR MASËS ADMINISTRATIVE TË DËNIMIT ME GJOBË”.**

BAZA LIGJORE:

1. Neni 132 e vijues të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918/2008**);
2. Neni 46 i ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr.10433/2011**);
3. Neni 128 e vijues të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (**ligji nr. 44/2015**);
4. Rregullore Nr.46 datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, miratuar me Vendimin Nr.2695, datë 27.10.2016 të Këshillit Drejtues;
5. Rregullore Nr.12 dt. 07.04.2010, “Për të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve, Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”;
6. Rregullore Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”;
7. Rregullore e Brendshme të Funkionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP;
8. Urdhëri nr. 343, dt 07.06.2018 (nr. 1729 Prot.) “Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Ankesa e sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “PC store” sh.p.k, me objekt “Rrëzimin e aktit administrativ të gjobës prej 20.000 (njëzet mijë) lekë” me shkresën e datës 15.08.2018 (nr.2141 Prot. i AKEP, datë 16.08.2018);
2. Projekt–Aktin “Mbi shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit “PC store” sh.p.k, kundër masës administrative të dënimit me gjobë”;
3. Autorizimin e Inspektimit nr.1825 Prot, datë 20.06.2018;
4. Procesverbalin e Inspektimit “Për Sipërmarrësit e Komunikimeve Elektronike”;
5. Vendimin Përfundimtar të Inspektimit, me shkresën nr.141, datë 01.08.2018, (nr. 1825/9 Prot. Datë 8.8.2018) dhe gjobën me nr. 88, datë 01.08.2018;
6. Njoftimi për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit me nr.1825/10 Prot, datë 8.08.2018;
7. Relacion shpjegues (Relacioni),

dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, dhe bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Në aspektin formal:

1. Ankimi i sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “PC Store” sh.p.k, i datës 15.08.2018, mbi gjobën e vendosur nga inspektorët e AKEP, është brenda afatit të parashikuar nga ligji nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe

plotëson kushtet për praninë të ankimit të parashikuara në nenin 135 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (Ligji nr. 44/2015, datë 30.4.2015).

2. Me Autorizimin e Inspektimit nr.1825 *Prot*, datë 20.06.2018, Kryetari i Këshillit Drejtues ka autorizuar inspektimin për: *“Të dhëna mbi sipërmarrësin e inspektimit”*, sipas adresës së çdo sipërmarrësi, në zbatim të Urdhërit nr. 343, dt 07.06.2018 (nr.1729 *Prot*.) *“Për procedurën e inspektimit në distancë, administrimin e informacionit të përfutur dhe planifikimit të tematikës së inspektimit dhe monitorimit”*, me objekt:

Përshkrimi i objektit të inspektimit në bazë të autorizimit të inspektimit me nr.1825 *Prot*, datë 20.06.2018 ka qënë verifikimi i zbatimit të:

- a) Detyrimit mbi plotësimin dhe dërgimin e Formularit G mbi të dhënat statistikore për 3 Mujorin e parë të vitit 2018, për sipërmarrësit sipas listës emërore:
10. “PC. Store” sh.p.k;
 - b) Detyrimit të raportimit të treguesve të cilësisë së 6 mujorit të dytë të vitit 2017, për sipërmarrësit sipas listës emërore:
21. “PC. Store” sh.p.k;
 - c) Sipërmarrësit pmr të cilët nuk kanë kryer pagesat për caktimin dhe përdorimin e frekuencave në AKEP sipas afateve, njoftimeve dhe rinjftimeve, sipas listës emërore;
 - d) Sipërmarrësit e komunikimeve elektronike të cilët nuk kanë kryer pagesën për caktimin dhe përdorimin e numeracionit në AKEP sipas afateve, njoftimeve dhe rinjftimeve, sipas listës emërore;
 - e) Sipërmarrësi radio televiziv i cili nuk ka kryer pagesën në AKEP sipas afatit, njoftimit dhe rinjftimit.
3. Në përputhje me objektin e inspektimit si dhe në bazë të Memos dt. 01.06.2018, nëpërmjet së cilës Sektori i Pagesave, Monitorimit dhe Zbatimit të Kontratave, ka referuar rastet e sipërmarrësve të cilët nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore ndaj AKEP, grupi i inspektimit, ka kryer veprimet sipas detyrave të përcaktuara dhe listës së kontrollit duke evidentuar me shkrim konstatimet si dhe çdo provë tjetër që lidhet me inspektimin.

Në bazë të konstatimeve të inspektimit si dhe përfundimeve të dala nga “Memo” drejtuar Kryetarit të AKEP “Mbi sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe postare të cilët nuk kanë plotësuar detyrimet rregullatore në AKEP”, mbi sipërmarrësin objekt inspektimi rezultuan shkelje të kërkesave ligjore dhe nënligjore.

4. Bazuar në faktet e konstatuara, shpjegimet dhe parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 137, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në

Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe të Rregullores Nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë së Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike”, Grupi i Inspektimit ka konstatuar se:

- Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “PC Store” sh.p.k me NIPT-i L01606034A, adresa, Rr. Dibrës, Vila Nr.153, Kati 1, Tiranë, nga verifikimet e grupit të inspektimit rezultoi se nuk ka dërguar formularin G me të dhënat statistikore për tre muajorin e parë 2018 si dhe nuk ka kryer raportimin për treguesit e cilësisë së gjashtëmuajorit të dytë të 2017.

Neni 16 i ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: *“Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike janë të detyruar t’i japin AKEP-it, me kërkesë të tij, çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur detyrimet funksionale të AKEP-it, sipas këtij ligji. Në veçanti, AKEP-i mund të kërkojë informacion, duke përfshirë informacione financiare, të cilat janë të nevojshme për: qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që rrjedhin nga marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe organizatave ndërkombëtare”*. Gjithashtu, Rregullore Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, në nenin 3 pika 2 përcakton se: *“Çdo sipërmarrës ka detyrimin që të plotësojë Formularët e listuar në nenin 4 (në vijim), duke dërguar formularët dhe informacionin e kërkuar sipas procedurave dhe afateve të kësaj rregulloreje”*. Rregullore Nr. 16 datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”, përcakton se: *“Të dhënat për treguesit e cilësisë se shërbimit duhet të grumbullohen dhe të llogariten mbi bazë tremujori duke nisur nga 1 Janari, 1 Prilli, etj. Sipërmarrësit duhet të dërgojnë në AKEP, deri në ditën e fundit të punës të muajit pasardhës të çdo gjashtëmuajori kalendarik, një raport me informacionin për 4 nivelet e cilësisë të regjistruara mbi bazë tremujore, për secilin nga treguesit, përjashtuar rastet kur në vetë aneksin përcaktohet një kohë tjetër limit”*.

Si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve nga Subjekti “PC Store” sh.p.k, që rrjedhin nga moszbatimi i gërmës ç) të nenit 16, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga moszbatimi i nenit 5, të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” dhe nga moszbatimi i Rregullores Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”, dhe në mbështetje të nenit 137/VII të ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se: *“Kur ndaj një subjekti konstatohen shkelje që nuk përbëjnë vepër penale, por përbëjnë kundërvajtje administrative, dënohen me gjobë në vlerën deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë”*, për sipërmarrësin e komunikimeve elektronike “PC Store” sh.p.k është dhënë dënimi administrativ kryesor me “Gjobë” në vlerën **20.000 (njëzet mijë) lekë**.

Grupi i inspektimit, për rregullimin e shkeljes së konstatuar, si dënim administrativ plotësues, i la detyrë sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “PC Store” sh.p.k, që të kryejë menjëherë raportimet e kërkuara nga AKEP, të bëjë korrigjimin e shkeljes së konstatuar dhe eliminimin e pasojave të tyre në mënyrë të menjëhershme, si dhe të njoftojë për korrigjimin e shkeljes brenda afatit të përcaktuar e të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.

Në aspektin e trajtimit në thelb të çështjes:

AKEP, pasi shqyrtoi materialet pjesë përbërëse të dosjes së inspektimit, konstatimet dhe konkluzionet e arritura në përfundim të procesit të inspektimit, vlerëson se:

- i. Grupi i inspektimit në zbatim dhe konform parashikimeve të Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike” dhe Urdhërit nr. 343, dt 07.06.2018 (nr. 1729 Prot.) ka kryer inspektimin në distancë në mënyrë të rregullt, ndaj sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “PC Store” sh.p.k.
- ii. Gjatë kohës së inpektimit nga grupi i inspektimit është thirrur dhe një përfaqësues i sipërmarrësit të komunikimeve elektronike “ PC Store” Sh.p.k, të cilit i është komunikuar dhe shpjeguar problematika në lidhje shkeljen e konstatuar nga ky subjekt, si rezultat i faktit se nuk ka dërguar formularin G me të dhënat statistikore për tre mujorin e parë 2018 si dhe nuk ka kryer raportimin për treguesit e cilësisë së gjashtëmujorit të dytë të 2017.
- iii. Sa i takon shkeljeve të konstatuara nga inspektorët, vërehet se, sipërmarrësi “PC Store” sh.p.k edhe pse është njoftuar nga strukturat e posaçme të AKEP të ngarkuara për zbatimin e detyrimeve rregullatore, nuk ka zbatuar detyrimet që rrjedhin nga gërma ç) e nenit 16 të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nga neni 5 i Rregullores Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të Dhënat Statistikore dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” dhe nga Rregullorja Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit” .
- iv. Për sa më lart u parashtrua, duke patur parasysh shkeljen e konstatuar, Inspektorët, bazuar në nenin 137 paragrafi VII, të Ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kanë të drejtë të vendosin gjobë dhe të kërkojnë marrjen e masave për ndreqjen e shkeljes.
- v. Gjoha është vendosur nga Grupi i Inspektimit, duke marrë për bazë dhe paragrafin 1/1 të nenit 137 të ligjit Nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet se, “Në vendosjen e gjobave sipas këtij neni do të merret parasysh: a) rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes; b) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes; c) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë, si dhe ç) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi, si dhe duke marrë për bazë dhe

pikën 3.14 “Kriteret për Vendosjen e Masave Administrative” të Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike”.

- vi. Pas marrjes së njoftimit për Vendimin Përfundimtar të Inspektimit me shkresën me nr 1825/10 Prot, datë 8.08.2018 si dhe Gjobës nr.88, datë 01.08.2018, Sipërmarrësi i komunikimeve elektronike “PC Store” sh.p.k i është drejtuar Këshillit Drejtues duke kërkuar anulimin e Gjobës nr.88, datë 01.08.2018, të vendosur nga inspektorët e AKEP, me pretendimin se: - subjekti nuk është njoftuar për përmbushjen e detyrimit të raportimit; - subjekti është njoftuar vetëm për përmbushjen e detyrimit ligjor të raportimit të pasqyrave financiare, detyrim të cilin e ka përmbushur me sukses; - email-et nga institucioni në vijim konstatohet se kanë shkuar në rubrikën Spam, Junk; - të gjithë treguesit e subjektit që nga lindja e bashkëpunimit me AKEP janë 0 (zero) pasi nuk ka ushtruar aktivitet në këtë drejtim; - nuk janë përmbushur afatet e lajmërimit nga ana e AKEP si dhe forma e lajmërimit dhe informimit për raportim elektronik.
- vii. Në përfundim të procedurës për shqyrtimin e ankimit dhe të pretendimeve të sipërmarrësit ankimues “PC Store” sh.p.k, pas arsyetimeve dhe akteve të paraqitura nga Grupi i Inspektimit, si dhe nga analiza e plotë e çështjes objekt shqyrtimi, konstatohet se, pretendimet e paraqitura nga sipërmarrësi në objektin e ankimit kundër dënimit administrativ me “Gjobë”, janë të pabazuara, pasi sipërmarrësit e komunikimeve elektronike janë të detyruar të zbatojnë ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Detyrimet ligjore për të gjitha subjektet, përfshirë dhe “PC Store” sh.p.k, lindin që nga momenti që subjektet marrin Autorizimin nga AKEP. Për më tepër, AKEP i ka njoftuar subjektet për detyrimet e tyre në lidhje me raportimet përkatëse, që subjektet janë të detyruar ti kryejnë në zbatim të Rregullores nr.12, datë 07.04.2010 “Për të Dhënat Statistike dhe Financiare Periodike të Sipërmarrësve të Rrjeteve dhe/ose Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike” dhe në zbatim të Rregullores Nr.16, datë 16.04.2010 “Për Treguesit e Cilësisë së Shërbimit”. Pretendimi se subjektit i kanë shkuar email-et e njoftimeve në rubrikën Spam dhe Junk, nuk përbën shkak për të justifikuar mospërmbushjen e detyrimeve ligjore nga ky subjekt.
- viii. Si përfundim, vendosja e masës administrative me “Gjobë” me nr. 88, datë 01.08.2018, për ligjet administrativisht pasi është e bazuar në dispozitat materiale dhe procedurale të ligjit nr. 9918/2008, i ndryshuar dhe Rregullores nr.46, datë 27.10.2016 “Metodika e Inspektimit të Veprimtarisë të Rrjeteve dhe Shërbime të Komunikimeve Elektronike” dhe si i tillë duhet të mbetet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në pikën 1 të nenit 114, në pikën 1 të nenit 115 dhe në pikën 1 të nenit 136 të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në zbatim nenit 130 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të rrëzojë ankimin administrativ të sipërmarrësit “PC Store” sh.p.k, të paraqitur me shkresën e datës 15.08.2018 (nr.2141 *Prot.* i AKEP, datë 16.08.2018).
2. Lënien në fuqi të dënimit administrativ kryesor, me “Gjobë” nr.88, datë 01.08.2018, në shumën me vlerë 20.000 (njëzet mijë) lekë.
3. Lënien në fuqi të dënimit administrativ plotësues, për të korrigjuar shkeljet e kërkesave ligjore, brenda 15 ditëve.
4. Të njoftohet sipërmarrësi “PC Store” Sh.p.k për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatë, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Ilir Zela

ANËTARË:

1. **Alban Karapici**
2. **Edlira Dvorani**
3. **Ketrin Topçiu**
4. **Klarina Allushi**